



## METATEKSTET SHQYRTIMORE TË KUJTIM SHALËS, AUTOR I 33 LIBRAVE

NGA **BEHAR GJOKA** Faqe 24

Vështrimi ndryshe i letërsisë shqipe në 27 veprat studimore. Librat për krijimtarinë e Kutelit

## FAMULLIA E SHNA PRENDES MONOGRAFIA E PANJOHUR E IMZOT FRANO ILIAS

Historia e të një prej famullive më të hershme shqiptare asaj të Shna Prendes në Kurbin

NGA **IMZOT FRANO ILLIA**

Faqe 22-23



# RILINDASI

Suplement i SHQIPTARJA.com

E diel

2 gusht 2015

Viti **IV** - Nr: **82**

e-mail: rilindasi@gmail.com

**Kryeredaktore;**  
Admirina Peçi



**Historia/** Blerja dhe e rindërtimi i pallatit GROSSER FELDERHOF nga Gjeorgj Sina, ndërtesë ku banoi deri në ditën e vetëvrasjes edhe Karl Gega...

## GJERGJ SINA DHE KARL GEGA

### Miqësia dhe bashkëpunimi mes dy kolosëve nga trojet shqiptare

## HISTORIA, DRURËT UNIKALË TË BENEDIKTINËVE NË SHQIPËRI

NGA **NDUE DEDAJ** Faqe 20-21

Gjashtë ultinjtë (Ltë-ni, Ltënj, Ltinj; nga shtrëmbërimi i fjalës latin) u sollën nga Roma si fidane të njomë nga themeluesit e kuvendit benediktin.



NGA **PJETER LOGORECI**

M e largpamësi, Baroni Gjeorgj Sina, kapitalin e fituar e vendosi në blerje pasurish të patundëshme, kryesisht në blerje tokash dhe ndërtesash (kjo rreth viteve 1840). Në mesin e shekullit të 19-të, ai njihet si pronari më i madh i tokave në Hungari, por jo vetëm. Edhe në Austri dhe Vjenë, ai arriti të blejë pjesë të mëdha tokash dhe trojesh, fshatra të tëra, si në Mauerbach pranë Vjenës, në Welehrad të Moravi-së (Wellehrad in Mähren, që atëkohë ishte Austri), Gföll, Fahrafeld, Leopoldsdorf. Në vitin 1814, Gjeorgj Sina kishte blerë një truall gjigand në Rappoltenkirchen, për të ndërtuar vëndgëndrimin e familjes, që ishte pjesë e ultësirës së Tulnit afër Vjenës. Aty ai ndërtoi residencën si dhe varrezën (Mau-

soleum) e famëshme të familjes. Egziston një listë e objekteve në pronësi të Baronit Sina në Vjenë, e formuluar në vitin 1841, e cila përmban rreth 12 objekte (pallate), adresat e tyre si dhe vlerat e blerjes. Numri i madh i trojeve që Sina bleu në Vjenë, bëri të nevojshme krijimin e një zyrje për administrim dhe ndërtim, ku Baroni punësoi si drejtor të firmës një arkitekt dhe inxhinier ndërtues të njohur, Josef Stauffer-in.

Si qëndër e kësaj firme shërbeu ndërtesa që në Vjenë njihet si...

VIJON NË FAGEN

18-19

ARKIVA | DOKUMENTE



► Pallati Sina ne Hoher Markt 8



► Pallati i Sina-s ne Fleischmarkt 20, Kafe – Restaurant



► Pallati i Sina-s ne Lugeck 7

► Felderhof 1 para rindërtimit nga Sina



**Historia e blerjes dhe e rindërtimit të pallatit GROSSER FELDERHOF nga Gjergj Sina, ndërtesë ku banoi deri në ditën e vetëvrasjes edhe miku i tij i afërt Karl Gega...**

# Gjergj Sina dhe Karl Gega

## Miqësia dhe bashkëpunimi mes dy kolosëve nga trojet shqiptare

NGA **PJETER LOGORECI**

**M**e largpamësi, Baroni Gjergj Sina, kapitalin e fituar e vendosi në blerje pasurish të patundëshme, kryesisht në blerje tokash dhe ndërtesash (kjo rreth viteve 1840). Në mesin e shekullit të 19-të, ai njihet si pronari më i madh i tokave në Hungari, por jo vetëm. Edhe në Austri dhe Vjenë, ai arriti të blejë pjesë të mëdha tokash dhe trojesh, fshatra të tërë, si në Mauerbach pranë Vjenës, në Welehrad të Moravi-së (Wellehrad in Mähren, që atëkohë ishte Austri), Gföll, Fahrafeld, Leopoldsdorf. Në vitin 1814, Gjergj Sina kishte blerë një truall gjigand në Rappoltenkirchen, për të ndërtuar vëndqëndrimin e familjes, që ishte pjesë e ultësirës së Tulnit afër Vjenës. Aty ai ndërtojte residencën si dhe varrezën (Mausoleum) e famëshme të familjes. Egziston një listë e objekteve në pronësi të Baronit Sina në Vjenë, e formuluar në vitin 1841, e cila përmban rreth 12 objekte (pallate), adresat e tyre si dhe vlerat e blerjes.

Numri i madh i trojeve që Sina bleu në Vjenë, bëri të nevojshme krijimin e një zyrje për administrim dhe ndërtim, ku Baroni punësoi si drejtor të firmës një arkitekt dhe ingjiner ndërtues të njohur, Josef Stauffer-in.

Si qendër e kësaj firme shërbeu ndërtesa që në Vjenë njihet si Pallati Sina e që ngrihet në qendër, në bashkinë e parë ose siç thonë vjenezët në "Innere Stadt" (qytetin e vjetër), në një zonë shumë të njohur të quajtur Hoher Markt, me numer 8. Ky pallat që më parë quhej Pallati Fellner u rikonstruktua nga arkitekti i famshëm Theophil Hansen me kërkesën Gjergj



Simon Sinës dhe përfundoj së ndëtuari në vitin 1859. Për herë të parë në Vjenë, sipas kërkesës së Gjergj Sinës, arkitekti Hansen ndërtoj këtë pallat në stilin Neorenaissance për qiramarrës, gjë që më pas hyri si modë në ndërtimet në kryeqytet. Pallati kishte një oborr ndërmjet dhe të gjithë katet ishin të stolisur me afreske nga piktorë të njohur si Karl Rahl apo Eduard Bitterlich. Sot ai nuk egziston, pasi u shkatërrua nga bombardimet e aleatëve gjatë luftës së dytë botërore dhe më vonë u shemb për të ndërtuar një pallat të ri banimi.



Pronë tjetër shumë e njohur në Vjenë është dhe pallati në Fleischmarkt 20-22, ku fillimisht Simon Sina i vjetri, kishte zyrat dhe filloj aktivitetet e tij tregtare dhe bankare, të cilin Gjergji e rinovoj në vitet 1825. Në vitin 1827 ai ndërtoj aty një Kafë - Restaurant me emrin "Zum weißen Ochsen" (Te Lopa e Bardhë), që ishte shumë e frekuentuar nga vjenezët, që sot mban emrin "Cafe Restaurant Vienna". Pallati ishte i ndërtuar për banim me qiradhënie. Në këtë pallat kishte dhe një sallë teatri që sot njihet si Drachengasse Theater. Shumë nga godinat në pronësi të familjes Sina ishin në qendër të qytetit, në "zonën greke", pranë njëra tjetrës, për rreth kishës ortodokse të rritit grek TRINIASHENJTE, e cila u ndërtua me financimin familjes Sina.

Për në shqiptarët, ndërtesa me e rëndësishme që patën Sina-jt, që na lidhë me një prej figurave më të ndritura të shqiptarve të Austrisë dhe konkretisht me figurën e arkitektit me famë botërore Karl Ghëga, është pallati GROSSER FELDERHOF 1. Ky pallat është i vendosur në sheshin me histori të famshme Lugeck. Godina njihet historikisht që në vitin 1497 dhe dikur quhej Tirnahof (emër që vinte nga familja Tirna) dhe më vonë Federhof, sipas emrit të tregtarit vjenez Georg Federl, që e zotëronte në vitin 1591. Ndër kohëra, ky pallat ishte vizituar apo banuar nga njerëz të mëdhej dhe shumë të njohur. Në vitin 1588 kishte jetuar aty kontesha Philippine Welsler nga Dinastia e Habsburgëve, më pas Paracelsus një mjek i përmendur nga Salzburgu që njihet edhe si Alkimiist, Astrologje dhe Filozof. Edhe e dashura e Kaisarit Karl i V, Barbara Blomberg kishte jetuar në këtë pallat. Më pas politikani Wallenstein (1633), akademiku Leibniz, historiani anglez William Robertson.

Pronari më i madh dhe më i pasur i shtëpive në Vjenë, Baroni Gjergj Sina, në vitin 1847 e rindërtoj krejtësisht këtë godinë të cilën e pat blerë në vitin 1825, duke e sjellë në pamjen që ka sot. Objekti gjindet në regjistrin e bashkisë në Vjenë me numër inventarit 768. Ajo që duhet të theksoj është se në këtë pallat ka banuar dhe miku i Baronit Gjergj Sina, arkitekti i hekurudhës së Semmeringut, inxhinieri me origjinë shqiptare Karl Ghëga. Karli kishte një apartament në katin e parë të pallatit me pamje nga rruga kryesore (Rotenturmstrasse). Poshtë parvizit të dritares ndodhet një tabelë që tregon vendin ku vdiq burri i famshëm. Deri vonë qarkulluan fjalët që ai në momente depresioni dhe merzie u hodh nga kjo dritare për ti dhënë fund jetës, për shkak se presioni që pat duke pritur bashkimin e tunelit që po ndërtonte ishte shumë i fortë. Miqësia me Gjergj Sinen ishte arsyeja që Karli banonte në këtë pallat. Njihën disa projekte në ndërtimin e hekurudhave austriake ku ato punuan së bashku, Karli si konstruktor dhe Gjergji si financues.

Autori J. Sachslehner në librin e tij mbi historikun e hekurudhave të Austrisë shkruan: "...mbretëria e Habsburgëve, për pak vite arriti vendin e parë ndër shtetet me hekurudha në Europë, falë personave si Franz Xaver Riepl, Carl Ritter von Ghëga, Baroni Georg Simon Sina dhe arqiduka Johann...."(1)

Në një raport të UNESCO-s për hekurudhën e Semmeringut shkruhet:.... historia do ju njohë me persona të cilët janë të lidhur ngushtë me ndërtimin e hekurudhës së Semmeringut si Arqiduka Johann, Kalorësi Karl Ghëga, Franz Riepl e Baroni Gjergj Sina....

Pra dy burrat me origjinë nga toka shqiptare ishin miq, bashkëpunëtorë si dhe shumë të përmendur për ndihmesën e tyre në të mirë të zhvillimit të Austrisë dhe të shkencës në përgjithësi.

Dihet nga historia e ndërtimit të hekurudhës më të famshme në botë, asaj të Semmeringut, që Karl Ghëges i nevojitej një lokomotivë e përshtatëshme, e fuqishme për tu ngjitur në lartësinë deri 898m. Lidhur këtë, në librin biografik mbi Karl Ghëgën, autori W. Straub shkruan:....Ghëga shpall një konkurs nga ku dolën 4 modele lokomotivash, ndër të cilat dhe ajo Vindobona të cilën Baronit Gjergj Sina mori përsipër ta ndërtojte në fabrikën e tij "Wien Gloggnitzer Eisenbahn Gesellschaft". Lokomotiva u paraqit në takimin konkurrues të datës 31 korrik 1851 së bashku me tri të tjerat. Pas disa provave që u bënë nga 20 gushti deri më 16 shtator, u përzgjodh modeli Bavaria i prodhuar në Firmën Maffei në Mynih.

Për projektet dhe investimet e Baronit Gjergj Sina në fushën e hekurudhave, pozicioni i Karl Ghëges si kryeinspektor i hekurudhave të perandorisë, si nëpunësi me i lartë përgjegjës për hekurudhat në qeverinë e Vjenës (pranë ministrit Baumgartner), ishte një mbështetje e vlefshme dhe e pakursyer. Le të mos mburren vetëm grekët me Gjergj Sinen dhe italianët me Karl Ghëgen, pasi kjo dyshe gjëniale Sina - Ghëga vjen nga viset shqiptare dhe është krenari legjitime për çdo shqiptar kudo që ndodhet.


**SHENIME:**

1Libri: Auf Schienen durch das alte Österreich me autor Johannes Sachslehner


Vjene, me 23 korrik 2015



► Pllakë perkujtimore në dritaren ku ka jetuar Karl Ghëga, në pallatin Sina



► Lokomotiva Vindobona, të cilën Gjergj Sina e ndërtoj për Karl Ghëgen



► Porta aktuale e pallatit Sina në Lugeck 7 dhe stema e familjes mbi porte

**Pronari më i madh dhe më i pasur i shtëpive në Vjenë, Baroni Gjergj Sina, në vitin 1847 e rindërtoj krejtësisht këtë godinë të cilën e pat blerë në vitin 1825, duke e sjellë në pamjen që ka sot**

